



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **60**

Prishtinë, më 15.12.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Hestet Cakolli, Berat Luzha, Selvie Halimi, Elheme Hetemi, Dragiša Mirić, Myrvete Pantina, Ali Lajçi.

Munguan : Zulfi Merxha, Zef morina.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : nga MBPZHR dhe vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku .

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i p/l për Organizmat e Modifikuar Gjenetikiisht,
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Naser Rugova-kryetar konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikiisht

Kryetari Naser Rugova njoftoi shkurtimisht për ecurinë e procedurës parlamentare lidhur me projektligjin e OMGJ-ve për të cilin ka pasur takim me zyrtarët e Ambasadës Amerikane dhe të USAID-it sugjerimi i të cilëve është që të tërhiqet ky projektligj dhe mundësisht mos të hyj në agjendën e vitit 2010 ngase mungojnë shumë gjëra të domosdoshme për zbatimin e këtij ligji siç janë ekspertizat, labororet, resurset njerëzore, institutet si dhe kapacitetet tjera të duhura.

Naim Maloku tha se situata është e qartë por kërkoi edhe mendimin e përfaqësuesit të ministrisë **Shefki Zeqirit** i cili tha se pajtohet me konstatimet e cekura të kryetarit mirëpo

theksoi se ministria e bujqësisë më 2007 ka hartuar këtë projekt me qëllim që të përmbushet korniza (baza) ligjore e Qeverisë.

Më tutje diskutuan edhe **Selvie Halimi, Elheme Hetemi, Heset Cakolli** pas së cilave komisioni nxori si vijon :

R E K O M A N D I M **për MBPZHR**

Në një afat sa më të shkurt Ministria e Bujqësisë të sjellë sugjerimin me shkrim lidhur me projektligjin për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht.

3. Të ndryshme

Naser Rugova në vazhdim **njoftoi** komisionin lidhur me takimin me përfaqësuesen Evropiane lidhur me çështjet e këtij komisioni për çka shprehu habinë pse ata nuk dërgojnë përfaqësuesin në mbledhjet e këtij komisioni, ndaj edhe u obligua koordinatori i komisionit që tani e tutje të ftoj ata në çdo takim të këtij komisioni. Biseda me këta zyrtar, ku ishte prezent edhe përfaqësuesi i OSCE, u fokusua në 4 drejtime : 1. bashkëpunimi me komisionin tonë, 2. bashkëpunimi me dy ministritë perkátëse të fushës së këtij komisioni (strategjia nacionale për mjedis), 3. ndihma konkrete me ligje për komisionin (një listë me ligje orijentuese) dhe 4. bashkëpunimi me TAIEX-in ku do të përfshihet një udhëtim studimor i komisionit në Bruksel me ndihmën e OSCE por edhe donatorëve tjerë nëse ka nevojë, gjithashtu është kërkuar një ekspert i lëmisë për nevojat e komisionit i cili do të bashkëpunonte dhe ndihmonte pa pasur nevojë për pagesë (Gazmend Selimi-ambientalist, është njëri nga ekspertët).

Gjithashtu , vazhdoi kryetari, është diskutuar për një mbledhje (ndoshta dy ditore) jashta Kuvendit të komisionit lidhur me hartimin e planit të punës në bashkëpunim me dy ministritë dhe komisionin evropian.

Lidhur me **Projektligjin për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore** kryetari njoftoi se komisioni për komunitete kërkon një takim të përbashkët me këtë komision, të cilin kërkesë disa anëtarë e kundërshtuan ngase ky komision me këtë tregon se nuk i ka kryer obligimet që i takojnë në cilësinë që e ka.

Naim Maloku kërkoi fillimisht sqarimet (agjendën për këtë takim) me shkrim nga ky komision, pastaj nëse ka nevojë mbahet takimi dmth të sqarohet çka nuk plotëson ky projektligj (të metat).

Elheme Hetemi pyeti sa kanë afat këta anëtar të komisionit të mbajnë një projektligj pa përfundua dhe konstatoi se kemi të bëjmë me një çështje politike (problem politik). Ajo kërkoi arsyetimet me shkrim nga ky komision ti dërgohen këtij komisioni brenda javës (para 25 dhjetorit), pastaj të vendoset për takimin e përbashkët.

Zyrtari i KDI-së tha se ka prezentuar në mbledhjen e fundit të komisionit për komunitete ku është thënë se Numan Baliq kryeson GP ku bëjnë pjesë edhe përfaqësuesit ndërkombëtar, mirëpo ky grup nuk është takuar afër 8 muaj. Kryesuesi i këtij komisioni ka konstatuar se pa rekomandime të këtij GP ky komision nuk mund të përfundoj këtë projektligj.

Në fund mbizotëroi mendimi i komisionit për një takim të përbashkët ndaj u nxor :

P Ë R F U N D I M

I. Mbahet takimi i përbashkët i këtij komisioni me komisionin për komunitete me datën 21.12.2009 në orën 11,00, ku përveç anëtarëve të rregullt të komisionit do të ftohen edhe përfaqësuesit tjerë (ndërkombëtar) që janë caktuar në grupin punues të komisionit për komunitete.

II. Për këtë takim të përbashkët komisioni funksional kërkon nga komisioni për komunitete të përgatitet agjenda e takimit përkatësisht arsyet pse nuk procedohet më tutje ky projektligj.

Për **Projektligjin për Mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare Myrvete Pantina** tha se ka diskutuar në komisionin për Buxhet ku është shprehur gatishmëria për procedim të mëtejme përkundër faktit se themelimi i Agjencisë me këtë Ligj paraqet implikim financiar. **Naim Maloku** në cilësinë e kryesuesit të GP për këtë projekt tha se MMPH ka arsyetuar themelimin e agjencisë në fjalë në kuadër të financave që i ka, pa tejkalluar kornizat financiare ekzistuese.

Komisioni kërkoj nga **Zef Morina** të angazhohet rreth projektligjit për të cilin është caktuar si kryesues i grupit punues.

Në fund **Kryetari** njoftoi se rekomandimet për projektligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja janë nënshkruar dhe përcjell komisioneve kryesore.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,10. Mbledhja e radhës do të mbahet më 21.12.2009 lidhur me projektligjin për Shitjen e Banesave bashkërisht me Komisionin për Komunitete.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova